

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2005 miraton

STATUTIN E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- (1) Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Akademia) është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Kosovë, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.
- (2) Për punën e vet Akademia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
- (3) Akademia është institucion i mëvetësishëm në fushën e shkencës dhe të artit.

Neni 2

- (1) Akademia është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe të konkretizuara me këtë Statut dhe me aktet e tjera normative të veçanta të saj.
- (2) Veprimtaria e Akademisë është veprimtari e interesit të veçantë publik për Kosovën. Veprimtarinë e saj Akademia e shtrin në tërë Kosovën.

Neni 3

- (1) Selia e Akademisë është në Prishtinë.
- (2) Akademia ka emblemën e vet.
- (3) Akademia e ka vulën e vet të rrumbullakët me tekstin në gjuhën shqipe dhe latine: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Academia scientiarum et artium kosoviensis-Prishtinë. Në mes të vulës është emblema e Akademisë me vitin e themelimit të saj.

Neni 4

- (1) Dita e themelimit të Akademisë është 20.12.1975.

Neni 5

- (1) Akademia organizon, zhvillon, nxit dhe e bashkërendon veprimtarinë shkencore dhe krijimtarinë artistike në seksione, bërthama të studimit, në njësi shkencore dhe artistike dhe në qendra studimore dhe hulumtuese.

Neni 6

- (1) Puna e Akademisë është e hapur.

(2) Puna e Akademisë financohet nga buxheti i Kosovës.

II. DISPOZITA TË VEÇANTA

Qëllimet dhe detyrat e Akademisë

Neni 7

Qëllimet e Akademisë janë:

- (1) zhvillimi, përparimi dhe nxitja e punës shkencore dhe artistike; përkujdesja për zbatimin e arritjeve shkencore; përkujdesja për kultivimin e vlerave artistike; zhvillimi i bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar;
- (2) zhvillimi i drejtimeve të reja specializuese shkencore dhe artistike;
- (3) t'i kushtojë rëndësi raportit të zhvillimit të disiplinave shkencore dhe të arteve si dhe përfaqësimit të tyre në Akademi, në përputhje me arritjet shkencore dhe artistike;
- (4) t'i realizojë qëllimet e veta nëpërmjet veprimtarisë së shkoqitur në programe dhe plane të punës.

Neni 8

Detyrat e Akademisë janë:

- (1) realizimi i projekteve shkencore dhe artistike dhe pjesëmarrja në to;
- (2) botimi i rezultateve të kërkimeve shkencore;
- (3) botimi i veprave të shkencës dhe të arteve (me rëndësi të veçantë për zhvillimin e shkencës dhe të arteve në Kosovë);
- (4) nxjerrja e botimeve të veta dhe e raporteve të punës;
- (5) organizimi i tubimeve shkencore, simpoziumeve, konferencave shkencore, sesioneve shkencore, tryezave shkencore etj. si dhe të ekspozitave, koncerteve, konsultave e të tjera;
- (6) pjesëmarrja në përcaktimin e synimeve të zhvillimit të shkencës dhe të arteve në Kosovë në mbështetje të proceseve bashkëkohore disiplinore dhe ndërdisiplinore të shkencës dhe të arteve;
- (7) shprehja e mendimeve dhe propozimeve mbi zhvillimin e shkencës e të artit;
- (8) kryerja e aktiviteteve të tjera që përcaktohen me Statutin e Akademisë.

III. ORGANIZIMI I AKADEMISË

1. Seksionet e Akademisë

Neni 9

- (1) Akademia formon seksione për një ose për më shumë fusha të shkencës dhe të arteve.

- (2) Në fushëveprimin e seksioneve bëjnë pjesë shkencat dhe artet që përcaktojnë emërtimin e seksionit.
- (3) Anëtarët e Akademisë janë anëtarë të atij seksioni të cilit i përket shkenca respektivisht arti me të cilin merren.

Neni 10

Akademia përbëhet nga këto seksione:

1. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
2. Seksioni i Shkencave Shoqërore.
3. Seksioni i Shkencave të Natyrës.
4. Seksioni i Arteve.

Me vendim të Kuvendit të Akademisë mund të themelohen edhe seksione të tjera.

Neni 11

- (1) Seksionet janë njësi themelore dhe bartëse të detyrave të Akademisë.
- (2) Në përbërjen e punës të seksioneve bëjnë pjesë anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë.
- (3) Në pajtim me Ligjin dhe me Statutin e Akademisë seksionet mund të themelojnë njësi shkencore e artistike dhe trupa të tjerë.
- (4) Seksionet formohen, bashkohen, ndahen dhe shuhen në pajtim me Statutin e Akademisë.
- (5) Numri i anëtarëve të një seksioni nuk është i kufizuar.

Neni 12

Seksionet kryejnë këto detyra:

- organizojnë punën shkencore a artistike nga fushëveprimi i tyre dhe hartojnë plane dhe programe të punës, të cilat ia paraqesin Kuvendit të Akademisë;
- i propozojnë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Akademisë nga fushat përkatëse;
- zgjedhin sekretarin e seksionit;
- i propozojnë Kryesisë përfaqësuesit e vet për tubime shkencore dhe mbledhje nga fushëveprimi i tyre;
- caktojnë recensentët profesionalë për punimet që botohen në organet e seksionit dhe të Akademisë;
- zgjedhin redaktorët për botimet e veta;
- kryejnë dhe punë të tjera nga fushëveprimi i tyre.

Neni 13

- (1) Seksioni merr vendime në mbledhje.

- (2) Për vendosje është e nevojshme që në mbledhje të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të seksionit.
- (3) Seksioni merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të seksionit.
- (4) Seksioni mund të mos e llogarisë në kuorum anëtarin i cili për shkak të sëmundjes më të gjatë ose për ndonjë arsye tjetër është i penguar të marrë pjesë në punën e seksionit.
- (5) Sëmundje e gjatë, ose ndonjë arsye tjetër, që ka qenë pengesë për të marrë pjesë në punën e Seksionit, konsiderohet koha më e gjatë se një vit.
- (6) Në mbledhjet e seksionit mbahet procesverbal.

Neni 14

- (1) Në krye të seksionit është sekretari.
- (2) Sekretari i seksionit zbaton vendimet e seksionit, e veçanërisht:
 - kujdeset për organizimin e punës dhe kryerjen e detyrave të seksionit;
 - përgatit dhe thërret mbledhjet e seksionit;
 - kryeson mbledhjet e seksionit;
 - informon Kryesinë dhe Kuvendin për punën e seksionit;
 - përfaqëson seksionin në trupat e Akademisë;
 - informon seksionin mbi konkluzat dhe propozimet e trupave të Akademisë;
 - redakton në parim botimet e rregullta të seksionit;
- (3) Sekretari i seksionit thërret mbledhjet sipas nevojës. Sekretari është i detyruar ta thërrasë mbledhjen edhe me propozimin e arsyetuar të së paku gjysmës së anëtarëve të seksionit.

2. Njësitë shkencore dhe artistike dhe trupat e tjerë

Neni 15

- (1) Me qëllim të shqyrtimit të problematikës së caktuar ose të çështjeve përkatëse nga fushëveprimi i saj, Akademia mund të themelojë njësi shkencore dhe artistike, bërthama studimi, qendra studimore dhe trupa të tjerë.
- (2) Njësitë shkencore dhe artistike, bërthama të studimit, qendra studimore dhe trupat e tjerë themelohen nga Kuvendi me propozimin e Kryesisë.
- (3) Dispozita më të hollësishme për punën e njësive shkencore a artistike, bërthamave të studimit, qendrave studimore dhe trupave të tjerë përmban Rregullorja e veçantë të cilën e nxjerr Kuvendi.
- (4) Njësitë shkencore a artistike, bërthamat e studimit, qendrat studimore themelohen për fushën e një seksioni apo të disa seksioneve.
- (5) Punën e njësisë shkencore dhe artistike, të bërthamave të studimit, të qendrave studimore e drejton udhëheqësi i zgjedhur nga Kryesia në bazë të konkursit.

- (6) Me rregullore të veçantë Kryesia e përcakton organizimin, mënyrën e punës dhe financimin e njësisë shkencore dhe artistike, të bërthamave të studimit e të qendrave studimore.

3. Tubimet shkencore, koncertet dhe ekspozitat

Neni 16

- (1) Akademia, përkatësisht seksionet e saj, mund të jenë organizues ose bashkorganizues të tubimeve shkencore, koncerteve, ekspozitave etj.

4. Ligjëratat

Neni 17

- (1) Ligjëratat në Akademi mbahen për anëtarë të Akademisë dhe për një rreth më të gjerë të punonjësve shkencorë ose të artit.
- (2) Ligjërues janë personalitete të dalluara nga vendi dhe bota.

5. Veprimtaria botuese

Neni 18

- (1) Veprimtaria botuese përfshin botimet e rregullta dhe të veçanta të Akademisë.
- (2) Veprimtaria botuese rregullohet me rregullore të veçantë, të cilën e nxjerr Kuvendi.

IV. ANËTARËT E AKADEMISË

1. Zgjedhja e anëtarëve

Neni 19

- (1) Akademia nuk ka numër të kufizuar të anëtarëve të vet.
- (2) Anëtarët e Akademisë janë të rregullt – akademikë dhe korrespondentë.
- (3) Akademia mund të ketë anëtarë nderi dhe anëtarë të jashtëm.
- (4) Anëtarët e rinj të Akademisë zgjidhen me vota të fshehta për çdo katër vjet në seancën zgjedhore të Kuvendit të saj.

Neni 20

- (1) Anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë të Akademisë mund të zgjedhen punonjës të shkencës dhe të artit për arritjet e veçanta në fushat e shkencave dhe të arteve.
- (2) Vetëm anëtarët e rregullt të Akademisë e kanë titullin Akademik.

- (3) Anëtar i rregullt i Akademisë – akademik zgjidhet punonjësi i shquar i shkencës dhe i arteve, shtetas i Kosovës, i cili jeton dhe vepron në territorin e Kosovës, rezultatet e punës të të cilit paraqesin realizime kulmore në fushën e shkencës dhe të arteve me peshë në vend dhe jashtë tij.
- (4) Anëtar i rregullt mund të zgjidhet anëtari korrespondent rezultatet e punës së të cilit që nga zgjedhja anëtar korrespondent paraqesin një arritje të lartë në fushën e shkencës ose të arteve dhe që gëzojnë një njohje të përgjithshme.

Neni 21

- (1) Anëtar korrespondent zgjidhet punonjësi i dalluar i shkencës a i arteve, shtetas i Kosovës, që jeton dhe vepron në territorin e Kosovës dhe që ka krijuar vepra shkencore a artistike të një rëndësie të veçantë.

Neni 22

- (1) Anëtar nderi i Akademisë mund të zgjidhet krijuesi i shquar i shkencës apo i artit, që nuk është shtetas i Kosovës, por që me realizimet e veta është bërë përgjithësisht i njohur për shkencën apo për artin dhe që ka dhënë ndihmesë për Kosovën.

Neni 23

- (1) Anëtar i jashtëm i Akademisë mund të zgjidhet punonjësi i shkencës dhe artit që jeton dhe vepron jashtë vendit, por që ka krijuar vepra të rëndësishme me vlerë për Kosovën ose me vlerë të përgjithshme për shkencën apo për artin.

Neni 24

- (1) Anëtarët e Akademisë zgjidhen nga Kuvendi i Akademisë në seancë zgjedhore me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të trupit të përhershëm të punës, të cilin e përbëjnë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë.
- (2) Anëtarët e rregullt zgjidhen nga anëtarët e rregullt me shumicën e votave.
- (3) Anëtarët korrespondentë zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të trupit të përhershëm të punës së Akademisë.
- (4) Anëtarët e nderit dhe anëtarët e jashtëm zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të trupit të përhershëm të punës së Akademisë.

Neni 25

- (1) Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë mund ta paraqesin: seksionet e Akademisë, Këshillat mësimorë-shkencorë të fakulteteve dhe këshillat shkencorë të instituteve shkencore publike, që financohen nga buxheti i Kosovës.

- (2) Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të nderit dhe të anëtarëve të jashtëm e bën Kryesia e Akademisë.

Neni 26

- (1) Seanca zgjedhore e Kuvendit të Akademisë në të cilën bëhet zgjedhja e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë, e anëtarëve të nderit dhe e anëtarëve të jashtëm të Akademisë, caktohet nga Kryesia e Akademisë së paku gjashtë muaj para mbajtjes së saj.
- (2) Propozimet i paraqiten Kryesisë së Akademisë më së paku tre muaj para ditës së mbajtjes së seancës zgjedhore.
- (3) Propozimet që i arrijnë Kryesisë jashtë afatit të përcaktuar me këtë Statut nuk merren parasysh.

Neni 27

- (1) Propozimet e recensentëve duhet të jenë të arsyetuara me raporte me shkrim.
- (2) Propozimet e arsyetuara duhet të përmbajnë veçanërisht:
 - të dhënat e hollësishme për punën shkencore dhe për veprat artistike të kandidatit të propozuar.
 - vlerësimet e plota të propozuesve mbi rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.
 - të dhënat mbi recensionet e mëparshme për rezultatet e krijimtarisë shkencore apo artistike të kandidatit të propozuar.

Neni 28

- (1) Propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë u dërgohen seksioneve përkatëse që ato të shfaqin mendimet e tyre për secilin kandidat.
- (2) Mendimin e tyre për kandidatët seksionet e shfaqin në bazë të raporteve me shkrim të më së paku dy anëtarëve të vet.
- (3) Për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt raportet i paraqesin anëtarët e rregullt.
- (4) Për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë raportet i paraqesin anëtarët e Akademisë.

Neni 29

- (1) Propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë i lihen në dispozicion opinionit dhe për këtë nxirret njoftimi në shtypin e përditshëm.
- (2) Kundërshtimet dhe vërejtjet eventuale në lidhje me propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, i paraqiten Kryesisë së Akademisë me shkrim dhe të nënshkruara brenda kohës së paraparë.

Neni 30

- (1) Seanca zgjedhore në të cilën zgjidhen anëtarët e Akademisë mbahet nëse në të është e pranishme shumica e anëtarëve të Akademisë.

- (2) Anëtar i Akademisë zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave të anëtarëve të Akademisë që e përbëjnë kuorumin e Kuvendit.
- (3) Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë rregullohet me rregullore të veçantë.

2. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve

Neni 31

Anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë të Akademisë kanë të drejta dhe detyrime të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut dhe posaçërisht:

- të marrin pjesë në veprimtarinë shkencore dhe artistike të Akademisë;
- të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Akademisë;
- të përfaqësojnë Akademinë kur u besohet kjo punë;
- të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit dhe të seksioneve që u përkasin;
- të kryejnë dhe detyra të tjera nga plani e programi i punës së Akademisë.

Neni 32

- (1) Të qenët anëtar i Akademisë është i përjetshëm.
- (2) Anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë u takon shpërblimi mujor (akademik) i anëtarit të Akademisë. Anëtarëve që kryejnë funksione të caktuara në udhëheqjen e Akademisë u takon shpërblimi përkatës. Shumën e shpërblimeve e cakton Kryesia.
- (3) Anëtarëve të Akademisë u takon shpërblimi përkatës mujor edhe për gjashtë muaj pas vdekjes.
- (4) Të qenët anëtar i Akademisë pushon me kërkesën nga vetë anëtari i Akademisë.
- (5) Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Akademisë pezullohen për kohën që ai nuk jeton dhe nuk vepron në Kosovë.

V. ORGANET DHE UDHËHEQJA E AKADEMISË

Neni 33

Organet e Akademisë janë: **Kuvendi, Kryesia dhe Kryetari.**

Kuvendi i Akademisë

Neni 34

- (1) Kuvendi është organi më i lartë qeverisës i Akademisë. Kuvendin e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë.
- (2) Në punën e Kuvendit të Akademisë mund të marrin pjesë edhe anëtarët e jashtëm të saj, pa të drejtë vote.

- (3) Seanca e Kuvendit të Akademisë konvokohet nga Kryesia e Akademisë, ose me propozimin e më së paku dy seksioneve të Akademisë apo të 10 anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.
- (4) Kuvendi i Akademisë ka këto kompetenca:
 - miraton Statutin e Akademisë;
 - nxjerr rregullore dhe akte normative të ndryshme që rregullojnë marrëdhënie të caktuara nga veprimtaria e Akademisë;
 - zgjedh anëtarët e rregullt, korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe të nderit të Akademisë;
 - zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm të Akademisë dhe verifikon zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të Akademisë;
 - miraton programin e punës së Akademisë dhe shqyrton realizimin e tij;
 - miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Akademisë;
 - merr vendime mbi themelimin dhe pushimin e punës të njësive shkencore dhe artistike dhe të trupave të tjerë të punës;
 - kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.
- (5) Seancat e Kuvendit mund të jenë të rregullta, të jashtëzakonshme dhe zgjedhore.
- (6) Seancat e rregullta mbahen së paku dy herë në vit.
- (7) Seancën e rregullt e thërret Kryesia më së paku 15 ditë para mbajtjes së saj.
- (8) Seancën e jashtëzakonshme e thërret Kryesia sipas nevojës së paku 8 ditë para mbajtjes së saj ose kur këtë e kërkojnë së paku dy seksione ose së paku gjysma e anëtarëve të Akademisë (prej të cilëve së paku gjysma e anëtarëve të rregullt).
- (9) Seanca zgjedhore në të cilën zgjidhet kryetari, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm dhe në të cilën verifikohet zgjedhja e sekretarëve të seksioneve, mbahet çdo tre vjet dhe thirret nga Kryesia së paku 30 ditë para mbajtjes së saj, ndërsa seanca zgjedhore në të cilën zgjidhen anëtarët e rinj të Akademisë mbahet çdo katër vjet dhe thirret nga Kryesia së paku 6 muaj para mbajtjes së saj.
- (10) Seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit mund të mbahen nëse në to merr pjesë mbi gjysma e anëtarëve, ndërsa seancat zgjedhore - nëse në to marrin pjesë mbi dy të tretat e anëtarëve.
- (11) Në seancat e Kuvendit vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin.
- (12) Në seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme vendoset për mënyrën e votimit, ndërsa në seancat zgjedhore votimi është i fshehtë.

- (13) Kuvendi mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë.
- (14) Sëmundje e gjatë ose ndonjë arsye tjetër që ka qenë pengesë për të marrë pjesë në punën e Akademisë konsiderohet koha më e gjatë se një vit.

Kryesia e Akademisë

Neni 35

- (1) Kryesinë e përbëjnë kryetari, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm i Akademisë dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë;
- (2) Mandati i anëtarëve të Kryesisë zgjat tre vjet dhe mund të përsëritet vetëm një herë rradhazi.
- (3) Kryesia e Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë;
- (4) Kryesia zbaton vendimet e Kuvendit të Akademisë dhe qëndrimet e tij;
- (5) Kryesia ka këto kompetenca:
 - të përgatitë seancat e Kuvendit dhe të zbatojë vendimet e tij;
 - të formulojë kërkesat dhe propozimet për Kuvendin;
 - të drejtojë punën e Akademisë në mes të seancave të Kuvendit;
 - t'i propozojë Kuvendit zgjedhjen e anëtarëve të nderit;
 - t'i propozojë Kuvendit themelimin e njësive shkencore dhe artistike dhe të trupave të tjerë të punës, të zgjedhë udhëheqësit e tyre dhe të nxjerrë rregulloret për punën e tyre;
 - të marrë vendime mbi veprimtarinë botuese të Akademisë;
 - të zgjedhë udhëheqësit e projekteve shkencore dhe artistike;
 - të zgjedhë sekretarin e Akademisë;
 - të thërrasë seancat e Kuvendit;
 - t'i paraqesë Kuvendit propozimin e planit dhe të programit të punës së Akademisë;
 - të themelojë delegacione, grupe pune dhe të zgjedhë delegatë (përfaqësues) të Akademisë;
 - të themelojë grupe konsultative;
 - të përcaktojë buxhetin dhe të bëjë llogarinë vjetore;
 - të kryejë punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut;
 - nxjerr rregullore dhe akte normative që rregullojnë marrëdhënie të caktuara për Shërbimet administrative, profesionale dhe teknike;
 - merr vendime për çështje të veçanta që lidhen me realizimin e veprimtarisë së Akademisë, për të cilat nuk vendosë Kuvendi i Akademisë;
- (6) Kryesia punon në mbledhje. Vendimet në Kryesi merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj.

Kryetari i Akademisë

Neni 36

- (1) Kryetari i Akademisë e përfaqëson Akademinë;
- (2) Kryetari i Akademisë përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- (3) Kryetari i Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë;
- (4) Kryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë. Ai i kryeson seancat e Kuvendit dhe të Kryesisë, kujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre dhe jep detyra nga kompetencat e tij.
- (5) Me personat e tretë dhe në marrëdhëniet pronësore juridike Kryetari paraqitet në emër të Akademisë dhe është urdhërdhënës për zbatimin e planit financiar të Akademisë.
- (6) Kryetari mund t'i kalojë disa nga autorizimet e veta te nënkryetari dhe sekretari i përgjithshëm i Akademisë.
- (7) Kryetari kryen edhe detyra të tjera, që ia ngarkon Kuvendi dhe Kryesia e Akademisë.

4. Nënkyetari i Akademisë

Neni 37

- (1) Nënkyetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt të Akademisë dhe e zëvendëson kryetarin e Akademisë në rast të mungesës së tij.
- (2) Nënkyetari i Akademisë kujdeset për zbatimin e konkluzioneve të Kryesisë dhe kryen punë të tjera, të cilat ia cakton Kryesia.

5. Sekretari i përgjithshëm i Akademisë

Neni 38

- (1) Sekretari i përgjithshëm i Akademisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë.
- (2) Sekretari i përgjithshëm i Akademisë:
 - bashkëpunon dhe bashkërendit veprimtarinë me sekretarët e seksioneve, me udhëheqësit e njësive shkencore e artistike dhe me udhëheqësit e trupave të tjerë;
 - organizon dhe bashkërenditë veprimtarinë botuese të Akademisë;
 - kujdeset për punën e njësive shkencore dhe artistike dhe të shërbimeve profesionale.

VI. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

Neni 39

- (1) Shërbimet administrative, profesionale e teknike i kryen Administrata e Akademisë.
- (2) Administratën e Akademisë e udhëheq Sekretari i Akademisë.
- (3) Sekretari i Akademisë zgjidhet me konkurs për katër vjet dhe mund të rizgjedhet.
- (4) Kushtet e konkursit i përcakton Kryesia e Akademisë.
- (5) Për punën e vet Sekretari i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë.
- (6) Punonjësit e Shërbimeve administrative, profesionale dhe teknike marrëdhëniet e tyre i rregullojnë me akte të veçanta normative, në pajtim me ligjin.

VII. MJETET E AKADEMISË

Neni 40

- (1) Mjetet themelore dhe financiare për punën e Akademisë sigurohen nga buxheti i Kosovës në zë të veçantë.
- (2) Me mjetet nga buxheti i Kosovës mundësohet puna e seksioneve, e njësive dhe e qendrave të tjera studimore të Akademisë, puna e organeve të qeverisjes së Akademisë, bashkëpunimi i jashtëm i Akademisë, veprimtaria e rregullt botuese dhe periodike e Akademisë, pasurimi i bibliotekës së Akademisë si dhe sigurohen shpërblimet e përhershme mujore të anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë, shpërblimet për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi, pagat e përhershme mujore për të punësuarit në shërbimet administrative profesionale e teknike dhe të mirëmbajtjes së Akademisë.
- (3) Financimi i projekteve të Akademisë bëhet në bazë të konkurseve të shpallura.
- (4) Akademia mund të sigurojë mjete edhe nga fondacionet dhe sponzorimet dhe ato mjete mund t'i përdorë për veprimtarinë plotësuese të saj.
- (5) Akademia mund të sigurojë mjete të tjera plotësuese për punën kërkimore-shkencore e artistike të anëtarëve të saj të rregullt dhe korrespondentë përmes aktiviteteve të veta, marrëveshjeve të ndërsjella kërkimore-shkencore e artistike dhe përmes donacioneve e dhuratave ose mbi ndonjë bazë tjetër juridikisht të lejueshme.
- (6) Mjetet e Akademisë përdoren vetëm për dobi të Akademisë dhe për qëllime e detyra të përcaktuara me këtë Statut.

Neni 41

- (1) Në buxhetin e Kosovës sigurohen mjetet mbi bazë të programit të punës së Akademisë.

- (2) Mjetet për veprimtarinë e rregullt të Akademisë janë:
- mjetet për pagat e të punësuarve në Akademi;
 - mjetet për shpërblimet e rregullta për anëtarë të Akademisë;
 - mjetet për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi;
 - mjetet për shpenzimet materiale dhe punët administrative të Akademisë dhe të njësive të saj;
 - mjetet për veprimtari botuese;
 - mjetet për mirëmbajtjen investuese të ndërtesës dhe pajisjeve të Akademisë.

Neni 42

- (1) Akademia është pronare e pasurisë që disponon.
- (2) Akademia është pronare e patundshmërisë që disponon (e godinës së Akademisë, e banesave, e ndërtesave dhe e pjesëve të ndërtesave), e bibliotekës, e koleksioneve shkencore e artistike dhe e gjësendeve të tjera, të cilat i ka siguruar nëpërmjet blerjes, dhuratave ose në ndonjë mënyrë tjetër.
- (3) Akademia udhëheq dhe disponon tërë pasurinë e vet.

Neni 43

- (1) Akademia në përputhje me qëllimet e caktuara, me planin financiar, i ndanë mjetet financiare për realizimin e detyrave të saj.
- (2) Mjetet e destinuara Kryesia e Akademisë mund t'i orientojë në mënyrë të mëvetësishme, pa marrë parasysh burimin e tyre.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 44

- (1) Akademia e harmonizon organizimin dhe punën e vet me dispozitat e këtij Statuti brenda gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.
- (2) Ditën që hyn në fuqi ky Statut, shfuqizohet Statuti i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës i datës 15 korrik 1997.
- (3) Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Akademisë.

KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Rexhep Ismajli